



Republika e Kosovës  
Republika Kosova-Republic of Kosovo  
Komuna e Prishtinës  
Pristina Obstina-Municipality of Pristina



**SEKTORI I PROKURIMIT - KABINETI I KRYETARIT**

Bazuar në nenin 108/A paragrafi 10 nënparagrafi 10.2 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik lidhur me nenin 60 të Ligjit nr. 05/L-068 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin nr. 04/L-237 dhe me ligjin nr. 05/L-092, si dhe duke u bazuar në nenin 61.3. lidhur me nenin 62 paragrafi 62.1 nënparagrafi d) si dhe nenin 63 paragrafi 63.1 nënparagrafi 63.1.1 të Rregullores (A01) nr. 001/2022 për Prokurimin Publik, duke vendosur sipas kërkesës për rishqyrtim të operatorit ekonomik “MB POWER” të datës 04.09.2024 kundër njoftimit mbi vendimin e datës 30.08.2024 lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull “122 Ndërtimi, zgjerimi dhe modernizimi i rrjetit të ndriçimit publik” me nr. të prokurimit 616-24-3392-5-1-1, Komuna e Prishtinës (autoriteti kontraktues) përmes zyrtarit përgjegjës të prokurimit nxjerr këtë:

## V E N D I M

- I. **REFUZOHET** kërkesa për rishqyrtim e operatorit ekonomik “MB POWER” të datës 04.09.2024 kundër njoftimit mbi vendimin e datës 30.08.2024 lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull “122 Ndërtimi, zgjerimi dhe modernizimi i rrjetit të ndriçimit publik” me nr. të prokurimit 616-24-3392-5-1-1.
- II. **AUTORIZOHET** autoriteti kontraktues - Komuna e Prishtinës që të vazhdoj me aktivitetin e prokurimit të përcaktuar si në pikën I të këtij vendimi.
- III. **NJOFTOHEN** palët e interesuara lidhur me këtë vendim përmes publikimit në platformën elektronike E-Prokurimi në adresën <https://e-prokurimi.rks-gov.net>.
- IV. Vendimi hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit.

### Arsyetim

Operatori ekonomik “MB POWER” (tutje “parashtruesi”) me datë 04.09.2024 ka paraqitur kërkesë për rishqyrtim kundër njoftimit mbi vendimin e datës 30.08.2024 lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull “122 Ndërtimi, zgjerimi dhe modernizimi i rrjetit të ndriçimit publik” me nr. të prokurimit 616-24-3392-5-1-1.

Gjatë shqyrtimit paraprak të kërkesës për rishqyrtim të parashtruesit është gjetur se kërkesa është e lejuar dhe është parashtruar brenda afatit nga personi i autorizuar si dhe nuk ekzistojnë pengesa tjera për të shqyrtuar kërkesën e parashtruesit. Në këtë mënyrë janë plotësuar kushtet për të vazhduar me shqyrtimin meritor (*in meritum*) të kërkesës.

Pretendimet ankimore të parashtruesit janë si vijon:

Ku ne si OE jemi shperblyer me kontrate per LOT 3, pasi qe kemi qene tenderi i pergjegjshem me çmim me te lire, por AK e ka kerkuar vazhdimin e validitetit te ofertave per shkak te disa rrethanave, me date 19.07.2024 permes emailit ([Nexhmi.Makolli@rks-gov.net](mailto:Nexhmi.Makolli@rks-gov.net)), mirepo nuk e ka kerkuar permes platformes kerkesen per zgjatje te afatit ashtu siq e kerkon Rregullorja, por e ka bere permes emailit te tij zyrtari Nexhmi Mekolli. Pra, ne si GOE MB POWER; ELEKTROVALI; DINA COMPANY; WORLS MEDIUM si nuk na ka ardh asnje njoftim ne platforme per vazhdimin e validitetit te ofertave. Pra ne si GOE nuk kemi qene te njoftuar lidhur me kete kerkese per zgjatje te validitetit.

Lidhur me pretendimet ankimore fillimisht duhet sqaruar se sipas letrës standarde për tenderuesin e eliminuar, parashtruesi është shpallur si tenderues i papërgjegjshëm dhe është eliminuar nga aktiviteti i prokurimit për arsyet si në vijim:

**Tenderi juaj është refuzuar për këto arsye:**

Nuk e ka vazhduar validitetin e ofertës

Sa i përket pretendimeve ankimore duhet sqaruar që kërkesa për vazhdimin e validitetit është dërguar dhe publikuar me rregull nga autoriteti kontraktues. Përndryshe as vet parashtruesi nuk e konteston faktin që nuk e ka vazhduar validitetin e ofertës mirëpo pretendon se për shkaqe teknike nuk ka arritur që të lexoj me kohë kërkesën për vazhdimin e validitetit të ofertës.

Në këtë mënyrë është gjetur se parashtruesi ka dorëzuar ofertë të papërgjegjshme për të cilën me të drejtë është eliminuar nga aktiviteti i prokurimit, ndërsa të gjitha pretendimet e tij ankimore janë të pabazuara në tërësi.

Nga sa u tha më sipër është gjetur se parashtruesi nuk ka paraqitur argumente të qëndrueshme për të mbështetur pretendimet e tij. Prandaj kërkesa për rishqyrtim e parashtruesit është refuzuar si e pabazuar në tërësi.

Për pikën I dhe II të këtij vendimi është vendosur duke u bazuar në nenin 63 par. 63.1.1. nënparagrafin b) lidhur me nenin 62 par. 62.1. nënparagrafin d) të Rregullores nr. 001/2022 për Prokurimin Publik.

Për pikën III dhe IV të këtij vendimi është vendosur duke u bazuar në nenin 63 par. 63.2. të Rregullores nr. 001/2022 për Prokurimin Publik.

Bazuar në të thënat më sipër është vendosur si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

Prishtinë, 05.09.2024

Visar SHEHU

Udhëheqës i Sektorit të Prokurimit  
Komuna e Prishtinës



**Këshillë juridike:**

Pala e pakënaqur me këtë vendim mund të paraqes ankesë pranë Organit Shqyrtues të Prokurimit brenda afatit prej dhjetë (10) ditëve pas pranimit të këtij vendimi.